



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Datë: 23.07.2025

Numër Protokolli: 5041/2025

A.nr.1241/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare e kolegjit, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1241/2025, të datës 27.06.2025, të parashtruar nga ankuesi L.Z, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1241/2025, e datës 22.05.2024, e parashtruar nga ankuesi, L.Z.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 30.05.2025, i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me shpalljen e kandidatit të suksesshëm në procedurën e rekrutimit sipas referencës RN00017246.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, L.Z, më datë 27.06.2025 përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017246, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë i Pensioneve të Jashtme*”, në Departamentin e Pensioneve në Prishtinë, të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit, më datë 29.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 4411/2025, të datës 27.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.07.2025; Përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit të datës 17.07.2025; Renditja përfundimtare e datës 30.05.2025; Konkursin me numër reference RN00017246; Vendimin me numër protokoli Nr.177/2025 të datës 08.05.2025; Akt emërimit Nr.02/036 të datës 04.05.2024; Akt emërimit Nr.931/2024 të datës 04.05.2024; Akt emërimit Nr.932/2024 të datës 04.05.2024; Akt emërimit Nr.1970 të datës 30.09.2024; Akt emërimit Nr.1043/2024, të datës 04.05.2024; Njoftimin e datës 15.05.2025; Listën e aplikantëve; Njoftimin për test me shkrim të datës 20.05.2025; ***Njoftimin individual për ftesën në testin me shkrim për ankuesin L.Z, të datës 20.05.2025;*** Çelësin e intervistës me gojë; Formularin e vlerësimit individual të intervistës me gojë; Njoftimin për kandidatin fitues të datës 30.05.2025; Testin me shkrim për kandidaten fituese L.S; Aplikacionin me datë aplikimi 23.03.2025, për kandidatin L.Z së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 03.04.2025, për kandidatin D.N së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 01.04.2025, për kandidatin Sh.K së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 15.04.2025, për kandidatin Q.L së bashku me dokumentet e bashkangjitura.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, ***sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 20.03.2025, ka shpallë konkursin publik për pranim me numër reference RN00017246, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm , gjegjësisht për pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë i Pensioneve të Jashtme*”, me klasë të pozitës Profesional 1, një (1) vend pune, në Departamentin e Pensioneve në Prishtinë, i hapur për aplikim nga data 21.03.2025 deri më datën 19.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë (31) kandidatë, ndër ta edhe ankuesi, i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, ndërsa, nga shkresat e lëndës vërtetohet fakti se i njëjti nuk ka marrë pjesë në fazat tjera të vlerësimit profesional, respektivisht në vlerësimin e testit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 30.05.2025 ka publikuar Njoftimin për shpalljen e rezultatit përfundimtar, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë e suksesshme për procedurën përkatëse është shpallur L.S (92.6) pikë.

Pas publikimit të Njoftimin për shpalljen e rezultatit përfundimtar, të datës 30.05.2025, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi

pretendimin ankimor se edhe pas kalimit të fazës së verifikimit paraprak, i njëjti nuk ka pranuar ftesë për mbajtjen e testit me shkrim, andaj shton se në këtë rast organi i punësimit ka bërë shkelje të parimeve ligjore konkretisht parimit të transparencës pasi që i është mohuar pjesëmarrja në testin me shkrim. Kërkon nga Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa, Konkursin me numër reference RN00017246, ta anuloj në tërësi dhe ta rishpallë përsëri.

Kolegji i Këshilli në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimit me Nr.ref: RN00017246 dhe si rrjedhojë Kolegji nuk ka arritur të evidentoj shkelje esenciale ligjore e të cilat si të tilla do ta cenonin vlefshmërinë ligjore të kësaj procedure. Në këtë kontekst, fillimisht, Kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me referencë RN00017246, ku dhe vërtetohet se si kërkesa të përgjithshme formale për pozitën përkatëse janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor); Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.* Kolegji vlerësoj se kriteret e përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, i'u referuar dispozitave të nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më ë cilin është përcaktuar se: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”*

Po ashtu, Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimiit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë:

Neni 8: [Vlerësimi profesional]: *Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimiit me mbështetjen e NjMBNj.*

Neni 9: [Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim]: 1. *Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 7/22 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimiit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa esea mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimiit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa esea vlerësohet nga Komisioni i Pranimiit. 9. Esea vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimiit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuar nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimiit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNJ, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.*

Neni 10: [Vlerësimi nëpërmjet intervistës] 1. *Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimiit njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 8/22 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimiit i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimiit mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për*

kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitën e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të marrë më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve.

Kolegji i Këshillit, bazuar në kuadrin ligjor përkatës ka analizuar provat materiale lidhur me këtë çështje nga dhe ka gjetur se nuk qëndron pretendimi ankimor se ankuesi nuk është ftuar në testimin me shkrim, ngase sipas shkresave të lëndës rezulton se të gjithë kandidatët, të cilët kanë kaluar verifikimin paraprak dhe kanë fituar të drejtën për fazat e mëtejme të vlerësimit, përfshirë edhe ankuesin janë ftuar përmes e-mailit të datës 20.05.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, duke u njoftuar njëkohësisht për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së testit me shkrim. Rrjedhimisht, sipas provave materiale të kësaj çështje është vërtetuar fakti se ankuesi ishte njoftuar përmes postës elektronike për zhvillimin e kësaj faze të vlerësimit, konkretisht në e-mailin e tij **l.z@rks-gov.net**, adresë të cilën ankuesi e kishte paraqitur në aplikacionin e tij të datës 23.03.2025.

Ndërsa, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se vlerësimi në këtë proces rekrutimi ka qenë në kundërshtim me ligjin material dhe nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë në raport me kandidatët tjerë, e gjithashtu procesi i vlerësimit nuk ka qenë transparent, Kolegji i Këshillit, sipas Njoftimit të datës 15.05.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës, ka gjetur se ankuesi ishte përfshirë në listën e ngushtë duke u vlerësuar si kandidatë që ka plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, dhe rrjedhimisht për t'iu nënshtruar fazave tjera të vlerësimit, dhe si rrjedhojë siç u konfirmua me sipër i njëjti ishte ftuar edhe për testin me shkrim, kështu që mos pjesëmarrja e tij në testin me shkrim ka pamundësuar pjesëmarrjen në intervistën më gojë, andaj mbi bazën e këtyre fakteve nuk qëndron pretendimi se ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë në raport me kandidatët tjerë.

Me qëllim të shqyrtimit të të gjitha pretendimeve ankimore të ankuesit, i cili me rastin e parashtimit të ankesës në Këshill ka kundërshtuar Njoftimin përfundimtar për kandidatin e suksesshëm, Kolegji i Këshillit

ka shqyrtuar dosjen e kandidates fituese **L.S**, e përzgjedhur si kandidate me më së shumti pikë për pozitën përkatëse, nga dhe ka konstatuar se e njëjta posedon: Diplomën me numër Nr.1579/14, të datës 07.11.2012, të lëshuar nga Kolegji AAB, me të cilën vërtetohet e e njëjta ka përfunduar studimet themelore më datë 25.06.2014, në Programin Banka, Financa dhe Kontabilitet, duke marrë titullin Bachelor në Banka, Financa dhe Kontabilitet; Diplomën Nr.535/17, të datës 29.06.2017 të lëshuar nga Kolegji AAB, me të cilën vërtetohet e e njëjta ka përfunduar studimet Master, duke marrë titullin Master në Menaxhment dhe Informatikë, përkthazi me përvojën e punës pas diplomimit kandidatja me rastin e aplikimit në këtë konkurs ka bashkangjitur, Letrën e rekomandimit të datës 20.02.2015 të lëshuar nga Kosova Democratic Institut me të cilën vërtetohet se e njëjta ka qenë e angazhuar në Zyrën për ndërlidhje me qytetarë, Zyre kjo e themeluar në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës, gjithashtu posedon Letrën e referencës të datës 06.12.2017, të lëshuar nga Nënkryetari i Komunës së Gjakovës me të cilën vërtetohet se e njëjta ka qenë e sistemuar në Institucionin e

Komunës së Gjakovës nga data 01.06.2014 sipas marrëveshjes; Letrën e referencës të datës 20.12.2016, të lëshuar nga Drejtori i DPPA, në Komunën e Gjakovës me të cilën vërtetohet se që nga qershori 2014 e tuje është e punësuar në Komunën e Gjakovës. Kandidatja fituese në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017246, L.S përvojën e punës të bashkangjitur në aplikacion e ka dëshmuar edhe përmes Pasqyrës Së Trustit Pensional për periudhën kohore nga data 01.08.2002 deri më datën 27.12.2023, andaj mbi bazën e konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi e njëjta ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkursin e kontestuar, e duke qenë se edhe gjatë fazave të vlerësimit profesional ka arritur numrin më të madh të pikëve, atëherë, më të drejtë njësia përgjegjëse, në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore të MFPT, e ka shpallur si kandidate fituese për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë i Pensioneve të Jashtme”, veprim ky, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, e duke qenë se nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me numër reference RN00017246, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë i Pensioneve të Jashtme”, në Departamentin e Pensioneve në Prishtinë, të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1241/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, L.Z;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.